Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera. Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit për:



Udhëzime për përdorim, riparimin e defekteve, informacione shërbimi:
www.electrolux.com



Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:
www.electrolux.com/productregistration




Blini aksesore, pjesë këmbimi konsumi dhe origjinale për pajisjen tuaj:
www.electrolux.com/shop

KUJDESI NDAJ KLIENTIT DHE SERVISIMI

Ne ju rekomandojmë përdorimin e pjesëve origjinale.

Kur kontaktoni shërbimin, sigurohuni që keni të gatshme të dhënat si në vijim.

Informacioni mund të gjendet në plakën e informacionit. Modeli, PNC, Numri serial.

 Informacion sigurie –Paralajmërues/kaucion

 Informacion i përgjithshëm dhe këshilla

 Informacion ekologjik

Subjekt për tu ndryshuar pa njoftim.

1. ⚠ INFORMACIONE SIGURIE

Kjo pajisje mund të përdoret vetëm nga fëmijët mbi 8 vjeç dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, motorike apo mendore apo dhe me mungesë përvoje dhe njohurie vetëm nëse ata mbikëqyren apo u janë dhënë udhëzime përsa i përket përdorimit të pajisjes në mënyrë të sigurtë dhe që ata të kenë kuptuar rreziqet e mundshme. Fëmijët duhet të mbikëqyren për tu siguruar që ata nuk luajnë me pajisjen. Pastrimi dhe mirëmbajtja gjatë përdorimit nuk duhet të kryhet nga fëmijët përderisa ata janë nën 8 vjeç dhe nuk janë të mbikëqyrur.

Kjo pajisje nuk mund të përdoret në lartësi mbi 2000m.



E RËNDËSISHME! UDHËZIME SIGURIE TË RËNDËSISHME: LEXONI ME KUJDES DHE RUAJENI PËR REFERENCË NË TË ARDHMEN.



KUJDES!

Nëse dera ose dorezat e dyerve janë dëmtuar, furra nuk duhet të vihet në funksionim derisa të jetë riparuar nga një person i kualifikuar.



KUJDES!

Është e rrezikshme për cilindo person tjetër përveç personit të kualifikuar të kryejë çdo shërbim apo riparim që përfshin heqjen e një kapaku që jep mbrojtje nga ekspozimi i energjisë në mikrovalë.



KUJDES!

Lëngjet dhe ushqime të tjera nuk duhet të nxehen në enë hermetike pasi ato janë më të mundshme për shpërthim.

Kjo pajisje është prodhuar për përdorim shtëpiak dhe aplikacione të ngjashme si : ambiente kuzhine për stafin në dyqane, zyra dhe ambiente të tjera pune; shtëpi fermere;

tek klientët në hotele, motele dhe ambiente të tjera rezidenciale; në hotelet e llojit që ofrojnë fjetje dhe mëngjes.

Përdorni mikrovalën vetëm me kuti dhe enë kuzhine të sigurta.

Enët metalike për ushqimin dhe pijet nuk lejohen gjatë gatimit në mikrovalë.

Mos e lini sobën pa mbikëqyrje ndërkohë që përdorni enë plastike, letre apo të tjera me ushqim të djegshëm.

Soba me mikrovalë është projektuar për të ngrohur ushqim dhe pije. Tharja e ushqimit apo e rrobave dhe nxehja e jastëkëve ngrohës, shapkave, sfungjerëve, leckave të lagura dhe të ngjashme mund të rrezikojë lëndimin dhe ndezjen e zjarrit.

Nëse ushqimi që po ngrohet fillon të nxjerrë tym, MOS HAPNI DERËN. Fikeni dhe hiqeni nga priza sobën dhe prisni derisa ushqimi të mos nxjerrë më tym. Duke hapur derën ndërkohë që ushqimi nxjerr tym, ju mund të shkaktoni zjarr.

Ngrohja në mikrovalë e pijeve mund të rezultojë me zierje eruptive të vonuar, prandaj kujdesuni kur të veproni me enën.

Përmbajtja e shisheve me ushqim dhe kavanozave me ushqim për foshnja duhet të nxirren ose të tunden dhe temperatura duhet të kontrollohet para konsumimit, në mënyrë që të shmanget djegia.

Mos zieni vezë me lëvozhgë dhe vezët e ziera më parë nuk mund të ngrohen në mikrovalë pasi ato mund të shpërthejnë pasi të ketë mbaruar gatimi në mikrovalë.

1.1 Mirëmbajtja dhe pastrimi

Dera:

Për të hequr gjithë papastërtitë, pastroni rregullisht të dyja anët e derës, dorezat e derës dhe sipërfaqet e guarnicioneve me një pecetë të butë, të njomë. Mos përdorni pastrues gjërryes të fortë apo gjërryes metalik të mprehtë për të pastruar derën prej xhami të sobës pasi kjo mund të gërvisht sipërfaqen, e cila mund të rezultojë me shkatërrimin e xhamit.

Pjesa e brendshme e sobës:

Për pastrim, fshini çdo derdhje apo spërkatje me një pecetë të njomë të butë ose me një sfungjer pas çdo përdorimi ndërkohë që soba është e ngrohtë. Për ndotje të mëdha, përdorni pecetë të njomur me ujë me sapun disa herë derisa të keni hequr mbetjet. Mos zhvendosni kapakun e mikrovalës. Sigurohuni që uji me sapun apo thjesht uji të mos depërtojë në vrimat e vogla në mure, të cilat mund të shkaktojnë dëme të sobës. Mos përdorni pastrues me spërkatje për interiorin e sobës. Pastroni kapakun e mikrovalës, zgavrën e sobës, platformën rrotulluese dhe mbështetësen e saj pas përdorimit. Këto duhet të jenë të thata dhe pa yndyrë. Yndyra e grumbulluar mund të mbinxehet dhe të fillojë të krijohet tym apo të krijohet zjarr.

Pjesa e jashtme e sobës:

Pjesa e jashtme e sobës tuaj mund të pastrohet lehtësisht me ujë dhe sapun. Sigurohuni që keni një leckë të njomë me sapun, dhe më pas thani pjesën e jashtme me një pecetë të butë.

Paneli i kontrollit:

Hapni derën para se ta pastroni dhe çaktivizoni panelin e kontrollit. Tregoni kujdes kur pastroni panelin e kontrollit. Kur përdorni leckë të njomur me ujë, me kujdes fërkoni panelin derisa të pastrohet. Shmangni përdorimin e

sasive të mëdha të ujit. Mos përdorni ndonjë lloj pastruesi kimik apo gërryes.

Platforma rrotulluese dhe mbështetësja e platformës: Hiqni platformën dhe mbështetësen e platformës nga soba. Lani platformën dhe mbështetësen e platformës me ujë dhe sapun. Thajini me një copë të butë. Të dyja si platforma edhe mbështetësja e platformës janë të sigurta për tu përdorur në lavastovilje.



E RËNDËSISHME!

Pastroni sobën në intervale kohe të caktuara dhe hiqni mbetjet e ushqimit. Gabimet në mirëmbajtjen e sobës në kushtet e pastrimit mund të shkaktojnë keqësimin e sipërfaqes e cila mund të ndikojë më pas në jetëgjatësinë e pajisjes dhe ndoshta mund të rezultojë në situata të rrezikshme.

Duhet treguar kujdes, por jo duke zhvendosur platformën rrotulluese duke lëvizur enët nga pajisja.



E RËNDËSISHME!

Nuk duhet përdorur pastrues me avull.

Furra me mikrovalë është projektuar për vendosje me integrim.

Kjo pajisje dhe pjesët e saj të aksesueshme mund të nxehen gjatë përdorimit.



KUJDES!


Mbani fëmijët larg nga dera për të parandaluar rrezikun që ata të digjen.




E RËNDËSISHME!

Mos përdorni pastrues komercial për sobën, pastrues me avull, gërryes, pastrues të ashpër, apo të tillë që përmbajnë hidrokسيد natriumi apo pade pastrimi në ndonjë pjesë të sobës suaj me mikrovalë.

2. INSTALIMI







Mikrovala mund të vendoset në pozicionin A ose B:



Pozicioni	Numri Niche		
	Gj	Gj	L
A	562	550	450
B	562	500	450


Përmasat në (mm)

2.1 Instalimi i pajisjes



1. Hiqni paketimin dhe kontrolloni me kujdes për ndonjë shenjë dëmtimi.
2. Vendosni çengelët fiksues në bufenë e kuzhinës duke përdorur tabelën e udhëzimeve dhe modelin e furnizuar.
3. Vendosni pajisjen me ngadalë në kutinë e kuzhinës, dhe pa forcë. Pajisja duhet të vendoset në çengelët fiksues dhe më pas të ulet në vendin e vet. Në rast interference gjatë montimit, kjo vendosje është e kthyeshme. Korniza ballore e sobës duhet të vendoset në hapjen ballore të bufes.
4. Sigurohuni që pajisja është e qëndrueshme dhe nuk lëkundet. Sigurohuni që të ruhet distanca 4 mm midis derës së bufesë dhe pjesës ballore të kornizës (shih diagramin).

2.2 Lidhja e pajisjes me energjinë



- Kutia elektrike duhet të jetë lehtësisht e arritshme në mënyrë që të hiqet lehtësisht nga priza në rast emergjence. Ose mundësisht duhet të jetë e mundur për tu izoluar nga soba nga furnizuesi duke inkorporuar çelësin në telat e fiksuar në përputhje me rregullat e kabllove.
- Kordoni i furnizimit me energji mund të zëvendësohet vetëm nga një elektrikist.
- Nëse kordoni i furnizimit është dëmtuar, duhet të zëvendësohet nga prodhuesi, agjenti i tij i shërbimit ose personat e kualifikuar në mënyrë të ngjashme në mënyrë që të shmangët rreziku.
- Kutia nuk duhet të lihet pas bufesë.
- Pozicioni më i mirë për afër bufesë, shih (A).
- Lidhni pajisjen me një fazë 220-240 V/50 Hz me rrymë të alternuar me anë të një kutie të instaluar me tokëzim. Kutia duhet të lidhet me rrymë 10 A.
- Para instalimit, shtrëngoni një copë nga kordoni i furnizimit me energji për të lehtësuar lidhjen me pikën (A) kur pajisja të jetë instaluar.
- Kur fusni pajisjen në bufenë me pozicionuar lart anash, MOS përthyeri kordonin e furnizimit me energji.
- Mos zhysni kordonin e furnizimit me energji ose ta vendosni në ujë apo lëngje të tjera.
- Mos lejo që kablo furnizues të bie mbi sipërfaqe të nxehta apo të ashpra, siç mund të jetë zona e ajrit të nxehtë në pjesën e përparme të sobës.

2.3 Këshilla shtesë

Mos përdorni sobën me mikrovalë për të nxehur vajin për skuqje të thellë. Temperatura nuk mund të kontrollohet dhe vaji mund të shkaktojë zjarr. Për të përgatitur kokoshka, përdorni vetëm përgatitës kokoshkash speciale për mikrovalë.

Individët me STIMULUES KARDIAK duhet të konsultohen me mjekun e tyre apo prodhuesin e stimuluesit kardiak për masa paraprake përsa i përket sobave me mikrovalë.

Asnjëherë mos vendosni apo futni ndonjë objekt në zgavrën e hapjes së derës apo zgavrat e ventilimit. Në rast të ndonjë derdhjeje, fikni dhe hiqni menjëherë nga priza sobën dhe kontaktoni agjentin e shërbimit të autorizuar ELECTROLUX.

Asnjëherë mos modifikoni sobën në ndonjë mënyrë.

Përdorni vetëm platformë rrotulluese dhe suport për platformë të dizajnuar për këtë sobë. Mos e vini në punë sobën pa platformë rrotulluese.


Për të parandaluar thyerjen e platformës rrotulluese:

- Para se ta pastroni platformën me ujë, lëreni platformën të ftohet.
- Mos vendosni ushqime dhe enë të nxehta në platformë të ftohtë.
- Mos vendosni ushqime dhe enë të ftohta në platformë të nxehta.

As prodhuesi as shitësi nuk mund të pranojnë përgjegjësinë për dëme në sobë apo lëndime personale që kanë rezultuar nga gabimet gjatë procedurave jo korrekte të lidhjeve elektrike. Avujt dhe pikat e ujit mund të krijohen në muret e sobës ose përreth guarnicionit të derës dhe sipërfaqeve hermetike. Kjo është një dukuri normale dhe nuk është tregues për rrjedhje të mikrovalës apo mosfunksionim të saj.


3. PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

3.1 Sobë me mikrovalë



- 1** Fletë ballore
- 2** Llamba e sobës
- 3** Paneli i kontrollit
- 4** Button për hapjen e derës
- 5** Kapaku i valëve
- 6** Zgavra e sobës
- 7** Ambalazhim hermetik
- 8** Guarnicioni dërrë dhe sipërfaqe hermetike

3.2 Aksesorë




Kontrolloni për tu siguruar që aksesorët e mëposhtëm janë furnizuar:

- 1** Platforma rrotulluese
- 2** Suport i platformës rrotulluese
- Vendosni suportin e platformës rrotulluese në bazamentin e zgavrës.
- Më pas vendosni platformën mbi suportin e saj.
- Për të shmangur dëmtime të platformës rrotulluese, sigurohuni që enët dhe mbajtëset të jenë vendosur mirë në buzët e platformës kur ta lëvizni nga soba.

i Kur porosisni aksesorë, ju lutemi të informoni për dy njësi: emri i pjesës dhe emri i modelit tek shitësi juaj apo tek një agjent i shërbimit të autorizuar ELECTROLUX.

3.3 Paneli i kontrollit



1 Tregues dixhital në ekran:



Favorite



Ora e kuzhinës



Shkrija automatike



Mikrovala



Stop/Fshi



Siguresa për sigurinë ndaj fëmijëve



Regjistro orën



Segmente ekrani



Pesha



Nivelet e fuqisë

2 Çelësat e nivelit të fuqisë

3 Çelësat e preferuar

4 Çelësi i shkrijës së akullit automatikisht

5 Çelësi i orës së kuzhinës

6 Butonat Më shumë/Më pak

7 Start/Konfirmo/Çelësi i fillimit të shpejtë

8 Çelësi i ndalimit

9 Buton për hapjen e derës

4. PARA PËRDORIMIT TË PARË

4.1 Vendos në prizë

Kur furra është e mbyllur për herë të parë ju keni mundësi të vendosni orën. Soba ka një orë 24h.

1. Soba do të lëshoj një sinjal në ikonat e ekranit dhe do të fiket për gjysëm sekondë.

Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'on' ose 'oFF'.

2a. Për ta çaktivizuar orën, shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'oFF' dhe më pas shtypni butonin **START**. Furra është gati për t'u përdorur.

i Nëse e keni fikur orën dhe dëshironi ta ktheni atë përsëri, shtypni dy herë **OREN E KUZHINES** dy herë dhe ndiqni 2b.

2b. Për ta aktivizuar orën, shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'on' dhe më pas shtypni butonin **START**.

Shembull: Për të regjistruar orën 18:45.

1. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të rregulluar orën.

2. Shtypni **START** si çelës për konfirmim.

3. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të rregulluar minutat.

4. Shtypni **START** si çelës për konfirmim.

i Kur regjistrohet ora, ora e ditës do të shfaqet në ekran.

4.2 Standby (Modaliteti ekonomik)

Soba do të kalojë automatikisht në modalitetin standby nëse nuk do të përdoret brenda një kohe prej 5 min.

Shembull: Nëse ora nuk është regjistruar: Ekranin do të fiket.

Hapeni derën ose shtypni një buton çfarëdo për të dalë nga modaliteti standby.

Shembull: Nëse ora është regjistruar: Pas periudhës kohore 5 minutëshe, koha do të shfaqet.

4.3 Rregulloni orën kur është regjistruar

Ju mund të rregulloni orën me zile pasi të jetë regjistruar ora.

Shembull: Për të ndryshuar nga 18.45 tek 19.50.

1. Shtypni butonin **ORA E KUZHINES** dy herë.
2. Shtypni **START** si çelës.
3. Shtypni butonin **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet '19'.
4. Shtypni **START** si çelës.
5. Shtypni butonin **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet '50'.
6. Shtypni **START** si çelës.

4.4 Për të fshirë orën me zile dhe regjistroni standby (Modaliteti ekonomik)

1. Shtypni butonin **ORA E KUZHINES** dy herë.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'OFF'.
3. Shtypni **START** si çelës për konfirmim.

4.5 Siguresa për sigurinë e fëmijëve

Soba ka një karakteristikë sigurie e cila parandalon funksionimin aksidental të sobës nga një fëmijë. Pasi është regjistruar siguresa, asnjë pjesë e mikrovalës nuk do të funksionojë derisa siguresa të jetë fikur. Aktivizimi dhe çaktivizimi i siguresës është i mundur vetëm kur soba nuk është në funksionim.

Shembull: Për të aktivizuar siguresën. Shtypni dhe mbani **STOP** si çelës derisa simboli 'siguresa e fëmijëve' të aktivizohet.

Shembull: Për të çaktivizuar siguresën. Shtypni dhe mbani **STOP** si çelës derisa simboli 'siguresa e fëmijëve' të çaktivizohet.

i Kur siguresa për fëmijët është aktivizuar, të gjithë çelësat janë çaktivizuar përveç **STOP** si çelës.

5. FUNKSIONIMI

5.1 Gatimi në mikrovalë

Shembull: Për të nxehur supën 2 minuta dhe 30 sekonda në fuqi mikrovalë 630 W.

1. Shtypni çelësin e **NIVELIT TË FUQISË** në trekëndëshin djathtas derisa '630 W' të shfaqet në ekran.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të regjistruar kohën.
3. Shtyp **START** si çelës.

i Në modalitetin e gatimit në mikrovalë, ju mund të rregulloni nivelin e fuqisë së sobës duke shtypur çelësin direkt tek regjistrimet e kërkuara.

Ju mund të regjistroni nivelin e fuqisë kur soba punon, duke shtypur dhe mbajtur **NIVELIN** e sobës që kërkohet derisa fuqia e re shfaqet e regjistruar në ekran. Nivelet e

energjisë që janë tepër të larta apo kohët e gatimit që janë tepër të gjata mund të mbinxehin ushqimin duke rezultuar në zjarr.

Nëse keni selektuar 900 W dhe koha maksimale e mikrovalës mund të shtohet me 15 minuta.

Soba funksionon në çdo modalitet për 3 minuta ose më gjatë, ventilatori rri ndezur për 2 minuta pasi gatimi mbaron. Hapni derën dhe do ndalojë, mbyll derën dhe do vazhdojë prapë derisa 2 minuta të mbarojnë (përfshi kohën e hapjes së derës). Nëse soba punon për më shumë se 3 minuta atëherë do fillojë të punojë ventilatori.

Pas gatimit, tabakaja rrotulluese do të vazhdojë të rrotullohet derisa ena e gatimit të kthehet në pozicionin fillestar të startit. Drita e zgavrës do të mbetet

e ndezur deri në përfundimin e rrotullimit, ose për 5 sekonda (cilado që është më e madhe). Furra do të

lëshojë sinjal zanor kur të përfundojë. Nëse dera është hapur gjatë këtij procesi, rrotullimi do të ndalet.

5.2 Nivelet e fuqisë

Fuqia regjistrimi	Përdorimi i sugjeruar
900 W/LART	Përdoret për gatim të shpejtë ose ringrohje (p.sh. supë, tava, ushqim të konservuar, pije të nxehta, perime, peshk).
630 W	Përdoret për gatime të gjata të ushqimit të ngjeshur siç janë të skuqurat, piskavica dhe gatime tave, gjithashtu për gatime sensitive siç është krem djathi dhe ëmbël-sira brumi. Në këtë regjistrim të reduktuar, salca nuk do të ziejë dhe të derdhet dhe ushqimi do të gatuhet pa u derdhur në të dy anët.
450 W	Për ushqime të ngjeshura që kërkojnë kohë gatimi më të gjata kur gatuhet në mënyrë konvencionale (p.sh. bifekë) është e këshillueshme që të përdorni regjistrimin e fuqisë për të siguruar që mishi piqet.
270 W/SHKRIRJA	Për të shkrirë, selekto regjistrimin e fuqisë, për të siguruar që gatimi do të shkrirë si duhet. Ky regjistrim është gjithashtu ideal për oriz të zier, makarona, njoki dhe vezë të gatuar fort.
90 W	Për shkrirje të butë (p.sh. krem kuzhine ose pastë).
0 W	Për orën e kuzhinës/me zile.

W = WATT

5.3 Niveli i reduktuar i fuqisë

Modaliteti i gatimit	Koha standarte	Niveli i reduktuar i fuqisë
Mikrovala 900 W	15 minuta	Mikrovala 630 W

5.4 Rregullimi i kohës së gatimit gjatë gatimit

Ju mund të rregulloni kohën e gatimit gjatë gatimit.

Shembull: Për të shtuar 2 minuta (120 sekonda) përdorni **START** si çelës.

1. Shtypni **START** si çelës katër herë.
Koha e gatimit do të rritet me 120 sekonda.

5.5 Përdorim i çelësit stop


Shtypni **STOP** si çelës njëherë për të hyrë në modalitetin Paузë.

Shtypni **STOP** si çelës përsëri për të fshirë kohën e gatimit.

5.6 Ora e kuzhinës


Të regjistros orën e kuzhinës.

1. Shtypni **ORA E KUZHINES** si çelës.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të regjistruar kohën.
3. Shtypni **START** si çelës. Ora do të startojë automatikisht.

 Koha mund të zgjatet kur kohëmatësi është në funksionim duke shtypur butonin **START**. Funksioni i orës mund të përdoret vetëm nëse soba nuk është në funksionim.

5.7 Fillimi i shpejtë

Ju mund të startoni direkt gatimin me 900 W/LART për 30 sekonda duke shtypur **START** si çelës.

 Për të shtuar më shumë kohë shtyp **START** si çelës.

5.8 Pa sinjal

Fikni sinjalin.

1. Shtypn **ORA E KUZHINES** si çelës 3 herë derisa në ekran të shfaqet 'Soun'.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'oFF'.
3. Shtypni **START** si çelës.

Për të aktivizuar sinjalin.

1. Shtyp **ORA E KUZHINES** si çelës 3 herë derisa në ekran të shfaqet 'Soun'.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** derisa të shfaqet 'on'.
3. Shtypni **START** si çelës.

5.9 Pauzë

Për ta ndaluar ndërkohë që mikrovala është duke funksionuar.

1. Shtyp **STOP** si çelës për të hapur derën.
2. Soba do të ndalojë për mbi 5 minuta.
3. Shtyp **START** për të vazhduar me gatimin.


5.10 Favorite


Soba ka 3 receta favorite.

- ☆₁ Gjalp i shkrirë
- ☆₂ Çokollatë e shkrirë
- ☆₃ Kek me formë

Shembull: Për të shkrirë gjalpin.

1. Shtypni **FAVORITE 1** si çelës njëherë.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të zgjedhur peshën.
3. Shtypni **START** si çelës.

 Nëse segmentet në ekran kalojnë platformën rrotulluese, kjo tregon se ushqimi duhet të trazohet ose të hiqet. Për të vazhduar gatimin, shtypni **START** si çelës. Në fund të kohës së shkrirjes automatike, programi do të ndalojë automatikisht. Nivelet e fuqisë për të regjistruar më parë recetat favorite nuk mund të rregullohen.
1-4 Kek në forma mund të gatuhen.

 **KUJDES!** Çokollata mund të nxehet shumë! Nëse çokollata ka nevojë për më shumë kohë gatimi, atëherë

shtoni 10 sekonda.

Tregoni kujdes me çokollatën pasi mund të mbinxehet dhe të digjet.

Për të shkruar mbi Favoritet për recetat tuaja.

1. Shtypni çelësin e **NIVELIT TË FUQISË** për të selektuar fuqinë.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të regjistruar kohën.
3. Shtypni dhe mbani **FAVORITE** si çelës që doni të regjistroni derisa të dëgjoni sinjalin akustik dhe ylli favorit është i dukshëm.

Për të regjistruar sërish Favorite tek regjistrimet e fabrikës.

1. Shtypni **STOP** si çelës.
2. Shtypni dhe mbani **NIVELIT TË FUQISË 450 W** për 3 sekonda. Soba do të kalojë Favorite në regjistrimet e fabrikës.

5.11 Shkrirja automatike


Shkrirja automatike funksionon jashtë modalitetit të gatimit dhe kohës së gatimit bazuar në peshën e ushqimit.

Ju mund të zgjidhni 2 menu shkrirje automatike.

1. Shkrirja automatike: Mish/Peshk/Shpendë
2. Shkrirja automatike: Bukë

Shembull: Për të shkrirë 0.2 kg biftek.

1. Selektu menunë e shkrirjes automatike duke shtypur **SHKRIRJA AUTOMATIKE** si çelës një herë.
2. Shtypni butonat **MË SHUMË/MË PAK** për të zgjedhur peshën.
3. Shtypni **START** si çelës.

 Nëse segmentet në ekran kalojnë platformën rrotulluese, kjo tregon se ushqimi duhet të trazohet ose të hiqet. Për të vazhduar gatimin, shtypni **START** si çelës. Në fund të kohës së shkrirjes automatike, programi do të ndalojë automatikisht. Rregullimi i kohës/energjisë nuk është i disponueshëm në shkrirjen automatike.

6. TABELAT E GATIMIT

6.1 Favorite

Favorite	Pesha	Çelësi	Procedura
Gjalp i shkrirë	0.05-0.25 kg	☆ ₁	<ul style="list-style-type: none"> Vendosni gjalpin në një tavë xhami. Trazoni mirë pas gatimit.
Çokollatë e shkrirë	0.1-0.2 kg	☆ ₂	<ul style="list-style-type: none"> Ndani çokollatën në copa të vogla. Vendosni çokollatën në një tavë xhami. Trazoni kur të dëgjohet sinjali akustik. Trazoni mirë pas gatimit. <p>! KUJDES: Çokollata mund të nxeht shumë! Nëse çokollata do më shumë kohë, atëherë shtoni edhe 10 sekonda kohë gatimi. Tregoni kujdes me çokollatën pasi mund të mbinxehet dhe të digjet.</p>
Kek me formë	1-4 forma	☆ ₃	<ul style="list-style-type: none"> Pregatitsni kekun si në recetë. Vendosni formën në këndin e platformës. Lëreni për 30 sekonda pas gatimit.

6.2 Receta kek me forma

Kek me forma me shumë çokollatë	
Përbërësit për një kupë:	
2½ lugë çaji (25 g)	Miell
2 lugë gjelle (12 g)	Pluhur kakaoje
2½ lugë gjelle (30 g)	Sheqer Puhur
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj gatimi
¼ lugë çaji	Ekstrakt vanilje
1	Vezë mesatare

Metoda:

- Vendos të gjithë përbërësit e thatë në një kupë të madhe, përziejini mirë me një pirun.
- Shtoni vaj perimesh, ekstrakt vanilje dhe vezë, përziejini mirë.
- Vendosni kupën në mes të platformës.
- Përdorimi për gatim ☆₃. Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.

Pas gatimit, lëreni aty për 30 sekonda.

Dekoroni me një sasi krem çokollate të trazuar.

Këshillë: Për të pregatitur kek me çokollatë dhe portokall, zëvendësoni ekstraktin e vaniljes me ½ lugë çaji ekstrakt portokalli.

Kek me fruta pylli	
Përbërësit për një kupë	
2½ lugë gjelle (25 g)	Miell
2½ lugë gjelle (30 g)	Sheqer Puhur
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj gatimi
½ lugë çaji	Ekstrakt vanilje
1	Vezë mesatare
1½ lugë gjelle	Reçel fruta pylli pa fara

Metoda:

1. Vendos të gjithë përbërësit e thatë në një kupë të madhe, përziejini mirë me një pirun.
2. Shtoni vaj perimesh, ekstrakt vanilje dhe vezë, përziejini mirë.
3. Zhysni lugën në përzierje dhe kështu mund të trazoni më mirë.
4. Vendosni kupën në mes të platformës.
5. Përdorimi për gatimit ☆₃. Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.

Pas gatimit, lëreni aty për 30 sekonda.

Dekoroni me një sasi krem vanilje.

Kek me copa molle	
Përbërësit për një kupë	
2½ lugë gjelle (25 g)	Miell
2 lugë gjelle (30 g)	Sheqer kaf
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
¼ lugë çaji	Kanellë
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj gatimi
1	Vezë mesatare
1½ lugë gjelle (30 g)	Salcë molle
gjysëm (7 g)	Biskota digjitive. të thërrmuara

Metoda:

1. Vendosni të gjithë përbërësit e thatë (përveç biskotave) në një kupë, përziejini mirë me pirun.
2. Shtoni vaj vegjetal dhe vezë, përziejini mirë.
3. Me kujdes trazoni salcën e mollës duke përdorur një lugë që të rregullojë përzierjen.
4. Mbuloni sipërfaqen me biskota digjitive të thërrmuara.
5. Vendosni kupën në mes të platformës.
6. Përdorimi për gatimit ☆₃. Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.

Pas gatimit, lëreni aty për 30 sekonda.

Mbuloni me një lugë të madhe krem vaniljeje.



Kujdes! Salca e mollës do të nxehet.

Kek me gjalp kikiriku	
Përbërësit për një kupë	
2½ lugë gjelle(25 g)	Miell
2 lugë gjelle (30 g)	Sheqer kaf
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj gatimi
¼ lugë çaji	Ekstrakt vanilje
2 lugë gjelle (30 g)	Gjalp kikiriku i butë
1	Vezë mesatare

Metoda:

1. Vendos të gjithë përbërësit e thatë në një kupë të madhe, përziejini mirë me një pirun.
2. Shtoni vaj vegjetal, ekstrakt vanilje, gjalp kikiriku, dhe trazoni mirë vezët.
3. Vendosni kupën në mes të platformës.
4. Përdorimi për gatim ☆₃. Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.

Pas gatimit, lëreni aty për 30 sekonda.

Sipërfaqen mbulojeni me copa çokollate.
Këshillë: Përdorni gjalp kikiriku krokant nëse e preferoni.

Kek me karrota	
Përbërësit për një kupë:	
2 lugë gjelle (20 g)	Miell
2½ lugë gjelle(30 g)	Sheqer kafe i lehtë
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
¼ lugë çaji	Kanellë
¼ lugë çaji	Bazë arra muskat
1 lugë gjelle	Bazë bajame
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj luledielli
	lëkurë ½ portokalli
30 g	Karrotë e grirë
1	Vezë mesatare
Pregatitja e kremit:	15 g gjalp, i shkrirë 40 g sheqer i ngrirë, 40 g krem djathi, ½ lugë çaji lëng portokalli

Metoda:

1. Vendos të gjithë përbërësit e thatë në një kupë të madhe, përziejini mirë me një pirun.
 2. Shtoni vaj luledielli, lëng portokalli, karrotë të grirë dhe vezë, përziejini mirë.
 3. Vendosni kupën në mes të platformës.
 4. Përdorimi për gatim ☆₃. Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.
 5. Bëni sipërfaqen duke përzier gjalpin, sheqer kokërr, krem djathi dhe lëng portokalli të gjitha bashkë.
- Pas gatimit, lëreni aty për 30 sekonda.




Lëreni kekun të ftohet, më pas shtoni mbushjen.


Kek me lëkurë limoni	
Përbërësit për një kupë:	
2½ lugë gjelle (25 g)	Miell
2½ lugë gjelle (30 g)	Sheqer Puhur
¼ lugë çaji	Pluhur gatimi
1½ lugë gjelle (15 g)	Vaj gatimi
1 lugë çaji	lëkurë limoni
1	Vezë mesatare
Pregatitja:	1lugë gjelle lëng limoni përzihet me 2 lugë gjelle sheqer kastori

Metoda:

1. Vendos të gjithë përbërësit e thatë në një kupë të madhe, përziejini mirë me një pirun.
2. Shtoni vaj vegjetal, lëng limoni dhe vezë, përziejini mirë.
3. Vendosni kupën në mes të platformës
4. Përdorimi për gatim ☆₃ . Keku do të fryhet dhe do të dalë nga kupa gjatë gatimit.
5. Bëni lyerjen e sipërfaqes me përzierje lëng limoni me sheqer pluhur.
6. Pas gatimit, lëreni kekun, shpuni sipërfaqen, dhe më pas spërkatni sipërfaqen e kekut, lëreni për 30 sekonda.

6.3 Shkrija automatike

Shkrija automatike	Pesha	Çelësi	Procedura
Mish/peshk/shpendë	0.2-1.0 kg	 x1	<ul style="list-style-type: none"> • Vendosni ushqimin në tabaka torte në qendër të platformës. • Kur të dëgjohet sinjali akustik, nxirni ushqimin, riorganizoni dhe veçoni. Pjesët e holla të tabelës dhe vendet e ngrouta me qese alumini. • Pas shkrijes, mbajeni në qese alumini për 15-45 min, derisa të shkrijë e gjitha. • Mish i grirë: Kur dëgjohet sinjali akustik, nxirni ushqimin. Hiqni pjesët e shkrija nëse është e mundur. <p> Jo e përshtatshme për të gjithë pulën.</p>
Bukë	0.1-1.0 kg	 x2	<ul style="list-style-type: none"> • Shpërndani në një enë të sheshtë në qendër të platformës. Për 1.0 kg, shpërndani direkt në platformë. • Kur dëgjohet sinjali akustik, fiken, riorganizoni dhe hiqni pjesët e shkrija. • Pas shkrijes mbulojeni me qese alumini dhe lëreni 5-15 min derisa të shkrijë e gjitha.

-  Regjistroni vetëm peshën e ushqimit. Mos përfshini edhe peshën e enës. Për ushqimet që peshojnë më pak ose më shumë se pesha/sasia e dhënë në tabelë, përdorni manualin e përdorimit. Temperatura finale do të variojë në përputhje me temperaturën fillestare. Biftekët dhe bërçollat duhet të ngrihen në një shtresë. Mishi i grirë duhet të ngrihet vetëm në feta të holla.

6.4 Ngrohja e ushqimit dhe pijeve

Ushqim/pije	Sasi -g/ml-	Niveli i Fuqise	Ora -Min-	Metoda
Qumësht, 1 filxhan	150	900 W	1	mos e mbuloni
Ujë, 1 filxhan	150	900 W	2	mos e mbuloni
6 filxhanë	900	900 W	8-10	mos e mbuloni
1 tas	1000	900 W	9-11	mos e mbuloni
Një pjatë miell	400	900 W	4-6	mbulo, trazo gjatë gatimit
Supë/turli	200	900 W	1-2	mbulo, trazo pas nxehtjes
Perime	500	900 W	3-5	mbulo, trazo gjatë gatimit
Mish, 1 copë ¹⁾	200	900 W	3	shpërndani salcë mbi mbushjen, mbulo
Fileto peshku ¹⁾	200	900 W	3-5	mbulo
Kek, 1 fetë	150	450 W	½-1	vend në enë të sheshtë
Ushqim bebe, 1 kavanoz	190	450 W	½-1	zhvendosni në një enë të përshtatshme për mikrovalë, pas nxehtjes trazoni mirë dhe testoni temperaturën
Margarinë ose gjalp i shkrirë ¹⁾	50	900 W	½	mbulo
Çokollatë e shkrirë	100	450 W	3-4	trazoni herë pas here

¹⁾nga e ftohur

6.5 Shkrirja

Ushqimi	Sasi -g-	Niveli i Fuqise	Ora -Min-	Metoda	Koha e ndenjies -Min-
Gulash	500	270 W	8-9	trazoni ndërkohë që shkrin	10-30
Kek, 1 sftë	150	90 W	1-3	vend në enë të sheshtë	5
Fruta	250	270 W	3-5	nxirreni jashtë sipas rastit, hiqeni nëse është gjysëm e shkrirë	5

6.6 Gatimi nga ushqimet e ngrira

Ushqimi	Sasi -g-	Niveli i Fuqise	Ora -Min-	Metoda	Koha e ndenjies -Min-
Fileto peshku	300	900 W	9-11	mbulo	2
Një pjatë miell	400	900 W	8-10	mbulo, trazo pas 6 minutash	2

6.7 Gatimi

Ushqimi	Sasi -g-	Niveli i Fuqise	Ora -Min-	Metoda	Koha e ndenjies -Min-
Brokoli/Bizele	500	900 W	6-8	shto 4-5 lugë gjelle ujë, mbulo, - trazo nga mesi i gatimit	-
Karrota	500	900 W	9-11	prit në rrathë, shto 4-5 lugë gjelle ujë, mbulo, trazo nga mesi i gatimit	-
Pjekja	1000	630 W	34-38	sezoni për shije, vendosni në një tigan gatimi, kthejeni në anën tjetër gjatë gatimit	10
Fileto peshku	200	900 W	4-6	për shije, vendoseni në një pjatë qeramike, mbulojeni	2

i Nëse soba funksionon për 3 minuta ose më gjatë, ventilatori do të ndizet për 2 minuta pasi mbaron gatimi. Hapni derën dhe do ndalojë, mbyllni derën dhe do të fillojë sërish derisa të kenë mbaruar 2 minuta (përfshi edhe kohën e derës hapur). Nëse soba punon më pak se 3 minuta, ventilatori nuk ndizet.


7. SHENJA PARALAJMËRUESE DHE KËSHILLA


7.1 Enë gatimi të sigurt për mikrovalë

Enë gatimi	Mikrovala e sigurtë	Komente
Qese alumini/enë mbajtëse	✓ / ✗	Pjesë të vogla prej qese alumini mund të përdoren për të mbuluar ushqimin nga mbinxehja. Mbani qeset të paktën 2 cm larg mureve të sobës, pasi mund të krijohen shkëndija. Enët prej qese alumini nuk rekomandohen, vetëm nëse specifikohen nga fabrikuesi. Ndiqni me kujdes udhëzimet.
Kina dhe qeramika	✓ / ✗	Porcelani, qeramika, enë argjile xhami dhe kocke janë zakonisht të përshtatshme, përjashtoj ato me dekorime metalike.
Enë qelqi p.sh. tavë xhami ©	✓	Tregoni kujdes kur përdorni enë xhami fin pasi mund të thyhet apo plasaritet nëse nxehet menjëherë.
Metal	✗	Nuk rekomandohet të përdorni enë gatimi metalike duke përdorur fuqinë e mikrovalës pasi mund të krijohen shkëndija, që mund të çojnë në zjarr.
Enë plastike/polistireni psh. për ushqim të shpejtë	✓	Duhet të tregoni kujdes pasi disa enë mund të prishen, shkrijnë apo çngjyrosen në temperatura të larta.
Çanta frigoriferike/pjekjeje	✓	Duhet shtypur për të lënë avullin të dalë. Sigurohuni që çantat janë të përshtatshme për përdorim në mikrovalë. Mos përdorni lidhëse plastike ose metalike, pasi ato mund të shkrijnë ose të shkaktojnë zjarr për shkak të shkëndijave metalike.
Pjata letra, kupa dhe letër kuzhine	✓	Përdoreni vetëm për ngrohje ose për të thithur lagështinë. Tregoni kujdes pasi nga mbinxehja mund të shkaktojë zjarr.
Enë kashte dhe druri	✓	Gjithmonë mbikëqyreni sobën kur përdorni këto materiale pasi mbinxehja mund të shkaktojë zjarr.
Letër e riciklueshme dhe gazetë	✗	Mund të përmbajë ekstrakte metali që mund të shkaktojë shkëndija dhe rrjedhimisht zjarr.

7.2 Këshilla për gatimi në mikrovalë

Këshilla për gatimi në mikrovalë

Përbërja	Ushqimet me përqindje të lartë yndyre ose sheqeri p.sh. puding krishtlindje, byrek me mish) kërkojnë më pak kohë ngrohjeje. Tregoni kujdes pasi mbinxehja mund të shkaktojë zjarr.
Madhësia	Për çdo gatim duhet të bëni të gjitha copat në madhësi të njëjtë.
Temperatura e ushqimit	Temperatura fillestare e ushqimit ndikon në sasinë e kohës së nevojshme për gatim. Prisni ushqimet me mbushje (p.sh. me reçel dhe brumë) që të çlirojnë nxehtësinë apo avullin.
Organizimi	Vendosni pjesët më të trasha të ushqimit drejt me pjesën e jashtme të enës (p.sh. stika me mish pile).
Mbullo	Vendosni qese të ajrosur për mikrovalë ose kapak të përshtatshëm.
Shpimi	Ushqimet me lëvozhgë, lëkurë apo membranë duhet të shpohen në vende të ndryshme para se të gatohen ose të ringrohen pasi mund të formohet avull dhe të shkaktohet shpërthim i ushqimit (p.sh. patate, peshk, pulë, salsiçe).  E RËNDËSISHME! Vezët nuk duhet të nxehen duke përdorur fuqinë e mikrovalës pasi ato mund të shpërthejnë, edhe pasi gatimi të ketë përfunduar (p.sh. vezët poshe, të ziera fort)
Trazo, rrotullo dhe riorganizo	Për çdo gatim është esenciale të trazoni, rrotulloni dhe riorganizoni ushqimin gjatë gatimit. Gjithmonë shpini dhe riorganizoni nga ana e jashtme drejt qendrës.
Lënia në vend	Koha e lënies në vend është e domosdoshme pas gatimit për të siguruar që ngrohja të shpërndahet njësoj në gjithë ushqimin.
Mbulimi	Zonat e ngrohta mund të ruhen në copa të vogla qeseje, të cilat reflektojnë mikrovalët (p.sh. krahët dhe kofshët e pulës).

 Përdor mbajtëse tenxhereje apo dorashka kuzhine kur lëvizni ushqimin nga soba për të parandaluar djegiet. Gjithmonë hapni enët, përgatitësit e kokoshkave, qeset e gatimit në sobë etj. larg fytyrës dhe duarve për të shmangur djegiet nga avulli. Gjithmonë qëndroni pak larg derës së sobës kur e hapni për të shmangur djegiet nga avulli dhe nxehtësia që del. Prisni në feta gatimet e pjekura të mbushura pas ngrohjes për të çliuar avullin dhe për të shmangur djegiet.

8. RIPARIMI I DEFEKTEVE


Problemi	Kontrollo nëse . . .
Pajisja Juaj me mikrovalë nuk po punon si duhet?	<ul style="list-style-type: none"> • Siguresa në rutinë e siguresës punon. • Nuk ka pasur ndërprerje të energjisë. • Nëse siguresa godet, kontaktoni një elektrikist të kualifikuar.
Modaliteti i mikrovalës nuk po funksionon?	<ul style="list-style-type: none"> • Dera nuk është mbyllur si duhet. • Guarnicionet e derës dhe sipërfaqet e tyre janë të pastra. • Atëherë START si çelës është shypur.
Platforma nuk rrotullohet?	<ul style="list-style-type: none"> • Mbështetësja e platformës është lidhur si duhet me mekanizmin. • Pjesët e sobës nuk kalojnë përtej platformës. • Ushqimi nuk ka kaluar përtej këndit të platformës për të penguar kështu rrotullimin. • Nuk kas asgjë që pengon afër platformës.
Mikrovala nuk fiket?	<ul style="list-style-type: none"> • Izoloni pajisjen nga kutia e siguresave. • Kontaktoni një agjent të shërbimit të autorizuar ELECTROLUX.
Llamba e brendshme nuk funksionon?	<ul style="list-style-type: none"> • Kontaktoni agjentin e shërbimit të autorizuar ELECTROLUX. Llamba e interiorit mund të ndërrohet vetëm nga një agjent i shërbimit të autorizuar i trajnuar ELECTROLUX.
Ushqimi kërkon më shumë kohë për tu ngrohur apo për tu gatuar se më parë?	<ul style="list-style-type: none"> • Regjistroni një kohë më të gjatë gatimit (sasia dyfish = koha afërsisht dyfish) ose • Nëse ushqimi është më i ftohtë se zakonisht rrotulloni herë pas here ose • Regjistroni një gradë më të lartë energjie.
Dera nuk do të hapet për shkak të ndërprerjes së energjisë?	<ul style="list-style-type: none"> • Hapni derën me kujdes duke e tërhequr në këndin e poshtëm djathtas të xhamit të derës.

9. INFORMACIONE TEKNIKE


Voltazhi i linjës AC		220-240 V, 50 Hz, faza singëll
Kutia shpërndarëse/Qarku i shkurtër		Minimumi 10 A
Fuqia e kërkuar AC:	Mikrovala	1.4 kW
Fuqia e jashtme:	Mikrovala	900 W (IEC 60705)
Frekuenca e mikrovalës		2450 MHz ¹⁾ (Grupi 2/Klasa B)
Dimensionet e jashtme:	KMFE264TE	596 mm (Gj) x 459 mm (L) x 404 mm (Gj)
Dimensionet e zgavrës		342 mm (Gj) x 207 mm (L) x 368 mm (Gj) ²⁾
Kapaciteti i sobës		26 litra ²⁾
Platforma rrotulluese		ø 325 mm, xham
Pesha		afro 19 kg

- ¹⁾ Ky produkt plotëson të gjitha kërkesat e standardit evropian EN55011. Në konformitet me këtë standard, ky produkt është klasifikuar si pajisje e grupit 2 klasa B. Grupi 2 do të thotë që pajisja me qëllim gjeneron energji radio-frekuence në një formë të rrezatimit elektromagnetik për të ngrohur ushqimin. Pajisja e Klasës B do të thotë që pajisja është e përshtatshme për tu përdorur në ambiente shtëpiake.
- ²⁾ Kapaciteti i brendshëm është llogaritur duke matur gjerësinë, thellësinë dhe lartësinë maksimale. Kapaciteti aktual për të ruajtur ushqim është më i lartë.

10. PËRSA I PËRKET AMBIENTIT

Materiale riciklimi me simbolin .
Vendosni paketimin në kazanët e aplikuar për riciklim.

Ndihmoni për të mbrojtur mjedisin dhe shëndetin njerëzor dhe ricikloni pajisjet elektrike dhe elektronike.

Mos hidhni pajisjet e shënuara me simbolin  me mbeturinat shtëpiake. Riktheni produktin në qendrën lokale të riciklimit ose kontakttoni zyrën e komunës.

ЗМІСТ

1. ВАЖЛИВІ ВКАЗІВКИ З ТЕХНІКИ БЕЗПЕКИ.....	54
2. УСТАНОВЛЕННЯ	59
3. ЗАГАЛЬНИЙ ОГЛЯД ПРИСТРОЮ	63
4. ПЕРЕД ПЕРШИМ ВИКОРИСТАННЯМ.....	64
5. РОБОТА	65
6. РЕЦЕПТИ	69
7. КОРИСНІ ПОРАДИ	76
8. ЩО РОБИТИ, ЯКЩО	78
9. ТЕХНІЧНІ ХАРАКТЕРИСТИКИ	79
10. ЕКОЛОГІЧНА ДОВІДКА.....	79

МИ ДУМАЄМО ПРО ВАС

Дякуємо за придбання приладу Electrolux. Вибраний вами виріб є результатом поєднання багаторічного досвіду та новітніх технологій. Оригінальний і стильний — сконструйований із думкою про вас. Користуючись ним, ви завжди отримуватимете найкращий результат. Компанія Electrolux вітає вас!

Звертайтеся на наш веб-сайт:



Поради з використання, брошури, інструкції з усунення несправностей, сервісна інформація:
www.electrolux.com



Зареєструйте виріб, щоб отримати покращене обслуговування:
www.electrolux.com/productregistration



Придбання приладдя, витратних матеріалів та оригінальних запчастин для вашого приладу:
www.aeg.com/shop

РОБОТА З КЛІЄНТАМИ ТА СЕРВІСНЕ ОБСЛУГОВУВАННЯ

Рекомендується використовувати оригінальні запчастини.

При звертанні до сервісного центру необхідно мати наступну інформацію.

Її можна знайти на таблиці з технічними даними. Модель, номер виробу, серійний номер.

 Увага! Важлива інформація з техніки безпеки

 Загальна інформація й рекомендації

 Інформація щодо захисту навколишнього середовища

Дані можуть бути змінені без попередження.

1. ⚠️ ВАЖЛИВІ ВКАЗІВКИ З ТЕХНІКИ БЕЗПЕКИ

Забороняється використання цього пристрою дітям молодше 8 років; особам з послабленими фізичними, чутливими та психічними здібностями; особам без досвіду роботи з пристроєм або не знаючим, як його використовувати, за винятком коли пристрій використовується зазначеними особами під наглядом або керуванням осіб, які забезпечують безпечне використання і розуміння ризиків, пов'язаних з ним. Діти повинні користуватися пристроєм під наглядом, щоб простежити, що вони не граються ним. Очищення і обслуговування може здійснюватися тільки дітьми віком 8 років і старше і тільки під наглядом дорослих.

Цей прилад не призначений для використання на висотах понад 2000 м.



ВАЖЛИВО! ВАЖЛИВІ ВКАЗІВКИ З ТЕХНІКИ БЕЗПЕКИ: УВАЖНО ПРОЧИТАЙТЕ І ЗБЕРЕЖІТЬ НА МАЙБУТНЄ.



УВАГА!

У разі пошкодження дверцят або ущільнювачів експлуатація печі можлива лише після ремонту, проведеного компетентною особою.



УВАГА!

З міркувань безпеки всі дії, пов'язані з обслуговуванням або ремонтом печі, які передбачають знімання кришки, що забезпечує захист від випромінювання мікрохвильової енергії, має виконувати лише компетентна особа.



УВАГА!

Не підігрівайте рідину та іншу їжу у закритому посуді, оскільки вони можуть вибухнути.

